

Jorgjeta Marko mban pozicionin si Këshilltare e Ministrit në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

E diplomuar në Menaxhimin e Politikave Ekonomike nga Columbia University në Nju Jork, me rezultate të shkëlqyera, gjithashtu ka Bachelor në Matematikë dhe Ekonomi nga American University in Bulgaria, duke u graduar me nderime Cum Laude.

Në dhjetor 2021 deri në maj 2023, ka shërbyer si nëpunëse civile në Bashkinë e Tiranës, ku ka analizuar informacione ekonomike lidhur me planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve të mbështetjes për biznesin. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka kontribuar në publikimin e raportit vjetor “Investo në Tiranë”, një iniciativë e rëndësishme për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Nga qershor 2020 deri në nëntor ka punuar si konsulente dhe ekspert financiar në ARZH Tiranë, ku në këtë rol, ka përgatitur Manualin për Inovatorin e Suksesshëm dhe ka personalizuar Planin e Veprimit të Inovacionit për 10 SME në sektorin e TIK-ut në Shqipëri. Ajo ka përdorur metoda statistikore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat për të identifikuar strategji të reja financimi për këto ndërmarrje. Njëkohësisht, ajo ka hartuar një raport për “Vlerësimin e Shpejtë të Ndikimit të Koronavirusit,” duke përfshirë një sondazh që synonte 500 SME të prekura nga pandemia.

Ka zhvilluar aftësi të rëndësishme përmes trajnimeve dhe licensimeve, duke përfshirë trajnerin e SCORE dhe licencën e CEFE, duke u angazhuar aktivisht në zhvillimin e saj profesional. Ajo gjithashtu ka përfituar bursën MCW Global Young Leaders Fellowship dhe është pjesë e Akademisë së Institutit Suedez për Profesionistët e Rinj.

Me një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj avancimit të politikave ekonomike dhe mbështetjes së zhvillimit të biznesit, Jorgjeta Marko vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e situatës ekonomike në Shqipëri dhe është një figurë e rëndësishme në fushën e menaxhimit të politikave publike.